



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 14.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **09.02.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Cactus sh.a.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si pjesërisht e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Cactus sh.a.** e dt. 09.02.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi **206-23-13309-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 30.11.2023;
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi për Kontratë të datës 30.11.2023, me sqarimet e dhëna;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Cactus sh.a. me datën 09.02.2024, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi 206-23-13309-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 14.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkëlur nga AK sipas OE Cactus sh.a.:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 28 Specifikimet teknike

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Bazuar në kërkesat e paraqitura në Specifikacionin Teknik të dosjes se tenderit shihet kjarë se favorizohen në mënyrë të drejtpërdrejt dy kompani prodhuese të pajisjeve: DELL dhe EIZO, dhe duke eliminuar nga gara kompanitë e tjera.

Faktet:

Backup device (x1) është marr në mënyrë eksplicite dhe komplet prej DELL EMC PowerProtect nga <https://www.delltechnologies.com/asset/en-us/products/data-protection/technical-support/docu96150.pdf>

Pikat të cilat janë të kopjuara nga ky specifikacion teknik janë për DD3300, të listuara në vijim:

7 TB/h throughput with usage of SW plugins ... (referenca Backup device (x1)) ku në specifikat e DD3300 janë:

MAXIMUM THROUGHPUT (DD BOOST) Up to 7.0 TB/hr. Ku DD3300 boost në këtë rast është software plug in 4.2TB/h throughput without usage of SW plugins for deduplication on the source: MAXIMUM THROUGHPUT Up to 4.2 TB/hr
Minimum raw capacity on device should be 4TB ... dhe ... The device can be expanded up to 32TB of usable capacity: USABLE CAPACITY 4TB – 32TB

	DD3300	DD6900	DD9400	DD9900
MAXIMUM THROUGHPUT	Up to 4.2 TB/hr	Up to 15 TB/hr	Up to 26 TB/hr	Up to 41 TB/hr
MAXIMUM THROUGHPUT (DD BOOST)	Up to 7.0 TB/hr	Up to 33 TB/hr	Up to 57 TB/hr	Up to 94 TB/hr
LOGICAL CAPACITY ¹	Up to 1.6PB	Up to 18.7PB	Up to 49.9PB	Up to 81.3PB
W/ Cloud Tier	Up to 4.8PB	Up to 58.1PB	Up to 149.8PB	Up to 211PB
USABLE CAPACITY	4TB – 32TB	48TB – 288TB	192TB – 768TB	576TB – 1.25PB
W/ Cloud Tier	Up to 96TB	Up to 864TB	Up to 2.3PB	Up to 3.25PB
ES40 SHELF	N/A	4TB 7.2K SAS	8TB 7.2K SAS ³	8TB 7.2K SAS ³
D360 SHELF	N/A	4TB 7.2K SAS ³	8TB 7.2K SAS	8TB 7.2K SAS
FS25 SHELF	N/A	3.84TB SSD ²	3.84TB SSD ²	3.84TB SSD ²

BUILT-IN NETWORKING 4x 10G Base-T

Data can be sent to device through the LAN by using CIFS or NFS protocol. The device should be offered with a minimum of 4x 10G Base-T ports

The 10GBase-T card can auto-negotiate down to support 1GbE

	DD3300
BUILT-IN NETWORKING	1x Mgm't port 4x 10G Base-T

Monitorët: specifikacioni i kërkuar në mënyrë eksplicite është i shkruar për prodhuesin EIZO.

RX660 6MP 30" Medical Monitor - RadiForce | EIZO

Panel type	Color (IPS)
Backlight	LED
Size	76 cm
Native Resolution	3280x2048 (16:10 aspect ratio)
Display colors	10-bit colors (Display Port):1.07 bilion (maximum) colors 8-bit colors: 16.77 milion from pallete of 68 billion colors
Viewing Angles (H/V, typical)	176° / 176°
Brightnes (typical)	1000 cd/m2
Recommended Brightnes for Calibration	500 cd/m2
Contrast ratio (typical)	1500 : 1
Response Time (typical)	25ms (on/off)
Input Terminals	Display Port, DVI-D (dual link)
Output Terminals	Display Port (daisy chain)
USB	Upstream USB 2.0: Type-B; Downstream USB 2.0: Type-A x 2
Sensors	Backlight Sensor, Integrated Front sensor. Presence Sensor, Ambient Light Sensor
Features	Brightness Stabilizator. Digital Uniformity Equilizer
Preset Modes	CAL Switch (DICOM, CAL1, CAL2, Custom, sRGB, Text)
Other	CE (Medical Device Directive), EN60601-1, ANSI/AAMI ES60601-1 CSA C22.2 No.601-1, IEC60601-1, VCCI-B, FCC-B, CAN ICES-3 (B) RCM, RoHS, China

Brand Name Workstations: Specifikacioni i kërkuar është për DELL Precision 3460 SFF WS dhe eliminon prodhuesit e tjerë.

Audio	Minimum included internal speaker
Ports	Minimum 2 x USB 2.0 port with Power On - it is only DELL technology
	Minimum 1 x USB 2.0 port
	Minimum 1 x USB 3.2 Gen 2x2 Type-C port
	Minimum 3 x USB 3.2 Gen 1 ports
	Minimum 2 x USB 3.2 Gen 2 port
	Minimum 3 x DisplayPort 1.4a ports
	Minimum Universal audio port
Slots	Minimum 2 x USB 3.2 Gen 2x2 Type-C port - only Audio line out requested naming points only to DELL Precision 3460 SFF WS
	Minimum Half-height Gen 4 PCIe x16 slot
	Minimum Half-height Gen 3 PCIe x4 slot
	Minimum M.2 2230 slot for Wi-Fi and Bluetooth card
	Minimum M.2 2280 slot for solid-state drive
	Minimum 2 slots for M.2 2230/2280 for solid-state drive
	Minimum 3 slots for SATA 3.0 slot for 3.5/2.5-inch hard drive or optical drive
Minimum Chassis intrusion switch	

Referenca: <https://www.delltechnologies.com/asset/en-ca/products/workstations/technical-support/precision-3460-sff-spec-sheet.pdf>

8GB, 1 x 8GB, DDR5, 4800MHz, ECC, Single-channel 16GB, 1 x 16GB, DDR5, 4800MHz, ECC, Single-channel 16GB, 2 x 8GB, DDR5, 4800MHz, ECC, Dual-channel 32GB, 1 x 32GB, DDR5, 4800MHz, ECC, Single-channel 32GB, 2 x 16GB, DDR5, 4800MHz, ECC, Dual-channel 64GB, 2 x 32GB, DDR5, 4800MHz, ECC, Dual-channel 8GB, 1 x 8GB, DDR5, 4800MHz, Non-ECC, Single-channel 16GB, 1 x 16GB, DDR5, 4800MHz, Non-ECC, Single-channel 16GB, 2 x 8GB, DDR5, 4800MHz, Non-ECC, Dual-channel 32GB, 1 x 32GB, DDR5, 4800MHz, Non-ECC, Single-channel 32GB, 2 x 16GB, DDR5, 4800MHz, Non-ECC, Dual-channel 64GB, 2 x 32GB, DDR5, 4800MHz, Non-ECC, Dual-channel	PORTS & SLOTS	Front ports: USB 2.0 port USB 3.2 Gen 2 port USB 3.2 Gen 2 capable Type-C® port Universal audio port Rear ports: RJ45 Ethernet port USB 3.2 Gen 2 port (3) USB 3.2 Gen 1 ports Retasking line-out/headset audio port (3) DisplayPort 1.4a port Optional video port (HDMI 2.0a / DisplayPort 1.4a (HBR3)) VGA/USB Type-C with DisplayPort Alt mode
--	--------------------------	---

Te përshkrimi i specifikimeve teknike për "Brand Name Workstations" saktësisht kërkesa për "Graphic card Minimum video card with 12 GB GDDR6 with 4 mDP connections" dhe kërkesa për "Ports Minimum 3 x DisplayPort 1.4a ports" janë parashikuar gjithsejt 8 PORTE DP. Për ta eliminuar konkurrencën duke pas parasysh që është kërkuar tërë kjo sasi e porteve "DP" dhe maksimumi i monitorëve që janë paraparë për Workstation është 3, te kërkesa për Workstation Monitor saktësisht kërkesa për "Ports & Connectors" është kërkuar që monitori të posedoj edhe 1xVGA vetëm për të favorizuar një prodhues duke pasur parasysh që ky port është shumë i vjetër dhe kohëve të fundit nuk ofrohet më nga prodhuesit e kompjuterëve, projektorëve dhe televizorëve.

Nga faktet e shpalosura me lartë në këtë kerkese per rishqyrtim, shihet së Autoriteti Kontraktues – MINISTRIA E SHËNDETËSISË gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ka bere shkelje substanciale të nenit 7 dhe 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .

Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me lartë te kësaj kerkese per rishqyrtim dhe dokumentacionit te këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues- MINISTRIA E SHËNDETËSISË, që kërkesa jone per rishqyrtim të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe dokumenti të kthehet në Ri – vlerësim.

Dëmet materiale

Me rastin e shkeljes se dy neneve te lartpërmendura na kufizohet pjesëmarrja për shkak te kufizimit te pjesëmarrjes dhe favorizimit te prodhuesve te caktuar:

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore

Bazuar ne sqarimet e dhëna nga profesionistet e SISH-it si Njësi e Kërkesës, përgjigjet e AK-MSh ne lidhje me pretendimet ankimore, janë si ne vijim:

Sa i përket pretendimit rreth pajisjeve DELL dhe EIZO, ju njoftojmë se mund te ofrohet "Backup device (x1)", siç edhe është cekur ne përgjigjet, qe përmbush specifikimin teknik te përafërt dhe ekuivalent dhe qe kryen funksionin e njëjtë te zgjidhës se kërkuar. Pra është e pranueshme te ofrohet pajisje me performancë ekuivalente që mund të plotësojë kërkesat e përdoruesve të RIS dhe PACS. Zgjidhje te tille mund te ofrojnë prodhuesit e ndryshëm te njohur ndërkombëtarisht siç janë HPE, IBM, DELL, etj.

Sa i përket pretendimit rreth monitoreve, ju njoftojmë se sipas përgjigjeve të fundit të datës 30.01.2024, janë të pranueshëm monitorët me specifikimet ekuivalente. Pikat e shënuara me poshtë me të kuqe, janë të pranueshme edhe nëse zëvendësohen me të tjera specifika ekuivalente. Sa i përket pretendimit rreth Workstations, mund të ofrohet "Brand Name Workstation" siç edhe është cekur në përgjigjet, që përmbush specifikimin teknik të përafërt dhe ekuivalent, dhe që kryen funksionin e njëjtë të zgjidhës së kërkuar. Pra është e pranueshme të ofrohet pajisje me performancë ekuivalente që mund të plotësojë kërkesat e përdoruesve të RIS dhe PACS. Zgjidhje të tilla mund të ofrojnë prodhues të ndryshëm të njohur ndërkombëtarisht siç janë HP, DELL, Lenovo, etj.

Shënim: Specifikimet e harduerit synojnë të tregojnë nivelin e performancës së pritur. Zgjidhjet nga të gjithë prodhuesit janë të pranueshme për sa kohë që ato janë të mjaftueshme për përdorim klinik dhe administrativ nga zgjidhja e propozuar e rrjedhës së punës dhe PACS dhe të sigurojnë zgjidhje të mjaftueshme për përdorim klinik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. OE Cactus sh.a.
3. Operatorëve ekonomik të interesuar.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit